

Hapet Thirrja për Bursa për Stafin Akademik në Programin Erasmus + për në Universitetin e Romës “Foro Italico”

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Romës “Foro Italico”.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzagjatja e bursave:

-Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë, duke përfshirë edhe ditët e udhëtimit);

Fushat e studimit:

- Shkencat Sportive

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

-CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Një letër motivimi (në gjuhën angleze);

-Kategoria Profesor (Kopje e Diplomes/ KVTA);

-Përmbledhja e Programeve apo projekteve ku ka marrë pjesë në 5 vitet e fundit;

-Certifikata e gjuhës së huaj;

-Vërtetim punësimi;

-Vërtetim nga fakulteti që ju lejon të shkëputeni për të kryer mobilitetin.

Afati për aplikime: 23 Janar 2017

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën sshabanaj@ust.edu.al. Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Teknologjisë së informacionit në adresën: sshabanaj@ust.edu.al.

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!